



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

STANDARDI PROFESIONAL

PRODHUESIT E KULTURAVE TË PËRZIERA DHE TË KAFSHËVE

Sektori: Bujqësi

Kodi: ISCO 08 (6130)

Data e miratimit:

Ky standard profesional është zhvilluar nga projekti “ALLED – Harmonizimi i Arsimit me Kërkesa të Tregut të Punës (Kosovë)”

Ekipi i zhvillimit:

Udhëheqës i ekipit:

Sadete Gashi, SHML “Abdyl Frashëri” Prishtinë

Përbërja e ekipit:

Qëndresa Qelaj, SHML “Abdyl Frashëri” Prishtinë

Emin Haziri, SHML “Jonuz Zejnullahu” Viti

Shani Cena, SHML “Selajdin Mullaabazi-Mici” Rahovec

Shpresa Hadri SHML “Kadri Kusari” Gjakovë

Afrim Shabani, SHML “Kadri Kusari” Gjakovë

Shqipe Dreshaj, SHML “Abdyl Frashëri” Prishtinë

Fatos Lajqi, SHML “Ali Hadri” Pejë

Data e miratimit:

Valide: Për periudhën prej 6 vite

Kodi i profesionit: 6130 (ISCO 08)

Profesioni: Prodhuesit e kulturave të përziara dhe të kafshëve

Përshkrimi i profesionit

Prodhuesit e kulturave të përziara dhe të kafshëve përgatisin dhe kryejnë aktivitete pune në tokat bujqësore dhe të hortikulturës si dhe në fermat për rritjen e kafshëve. Punon në pronat private, shtetërore apo publike bujqësore në operacionet sa i përket prodhimit, përpunimit në fermë dhe tregtisë së produkteve bimore dhe shtazore.

Drejtojnë (administrojnë) njësi të vogla të ndërmarrjeve bujqësore ose ferma. Orari i punës varet nga kërkesat e procesit të prodhimit. Kushtet e punës në shumë operacione kërkojnë përdorimin e masave dhe mjeteve të sigurisë në punë.

Prodhuesit e kulturave të përziara dhe të kafshëve planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore për të rritur perime, pemë, fidane të ndryshme, pemë dekorative si dhe kultura të ndryshme të tjera, si dhe shtimin e kafshëve përmes shumëllojshmërisë së mbarështimit të tyre. Ata poashtu përdorin dhe mirëmbajnë mekanizmin bujqësor.

Marketingu, shitja dhe ose shpërndarja e produkteve bujqësore – blegtorale është aktiviteti komercial me të cilat angazhohen këta profesionist.

Profesioni: Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve

Nr.	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1	Përgatitet për vendin e punës	Ky funksion ka të bëjë me kontrollin e planit të punës, materialit prodhues si dhe përzgjedhjen e tij, përgatitjen e pajisjeve dhe veglave si dhe aplikimin e masave higjienike në punë.
2	Analizon, planifikon dhe organizon punën në fermë	Ky funksion ka të bëjë me analizën e të dhënave të prodhimit të biznesit si dhe bërjen e planeve afatshkurtra ditore dhe javore në fermë
3	Kryen aktivitetet operative në prodhimtarinë me prejardhje bimore	Ky funksion ka të bëjë me prodhimin e fidaneve perimore, kultivimin e perimeve në ambiente të hapura dhe të mbyllura, kultivimin e pemëve frutore si dhe fidaneve të tyre, kultivimin e drithërave, kulturave hortikulturale, mbrojtjen e tyre, si dhe transportin dhe deponimin e kulturave të vjelura bujqësore. Përdorimi i veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje bimore është poashtu pjesë e këtij funksioni
4	Kryen aktivitetet operative në prodhimtarinë me prejardhje blegtorale	Ky funksion ka të bëjë me aktivitetet rreth rritjes së kafshëve të fermave dhe përfshin: pastrimin e vendqëndrimit të kafshëve, ushqimin e kafshëve të fermës sipas gjendjes dhe kategorisë së tyre, përkujdesjen e tyre, si dhe përdorimit të veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje shtazore
5	Kryen punë komerciale, administrative, marketingu dhe shitjeje	Ky funksion ka të bëjë me kalkulimin e kostove në prodhimtarinë bujqësore – blegtorale, hulumtimin për blerjen e inputeve bujqësore dhe blegtorale si dhe përgatitjen e strategjisë së marketingut dhe shitjes së atyre produkteve..
6	Zbaton rregullat sigurisë dhe mbron ambientin	Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e rregullave të higjienës personale dhe sigurisë në punë, aplikimin e rregullave për siguri të ushqimit, aplikimin e praktikave të mira në trajtimin e kafshëve dhe bimëve si dhe aplikimin e praktikave miqësore ndaj mjedisit për hedhjen e mbeturinave.

Funksioni 1: Përgatitet për vendin e punës

Ky funksion ka të bëjë me kontrollin e planit të punës, materialit prodhues si dhe përzgjedhjen e tij, përgatitjen e pajisjeve dhe veglave si dhe aplikimin e masave higjienike në punë.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathësitë	Shkathësitë kyçe dhe shkathësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Kontrollon planin e punës	Rishikon planin e punës; Përgatitë listën e aktiviteteve të zakonshme në prodhimtarinë bimore sipas afateve kohore; Përgatitë listën e aktiviteteve të zakonshme në prodhimtarinë blegtorale sipas afateve kohore.	Hartimi i planeve afatshkurtra Kontrollimi i zbatimit të planit Llojet e materialeve prodhuese	Kontrolluese;	Të menduarit kritik
Kontrollon materialin prodhues në dispozicion dhe bën përzgjedhjen e tij	Bën ndërlidhja e materialeve me aktivitetet specifike; Përzgjedhja e materialit të duhur sipas llojit dhe sasisë për aktivitetin e caktuar; Bën kontrollin e materialit përkatës.	Certifikimi i repromaterialit Llojet e veglave, pajisjeve dhe mjeteve të punës Higjiena dhe siguria e materialeve, uniformës dhe rregullave të punës	Përzgjedhja dhe përdorimi i saktë i pajisjeve; Vlerësimi të situatës; Koordinimi të veprimeve sipas nevojës; Zbatimi të saktë të rregullave shëndetësore dhe higjienike	Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja Organizimi Negocimi
Përzgjedh dhe kontrollon veglat dhe pajisjet e punës	Përzgjedh veglat, pajisjet dhe mjetet e punës; Kontrollon veglat, pajisjet dhe mjetet e punës;	Instruksionet e pajisjeve dhe veglave operative		
Aplikon masat higjienike dhe të sigurisë në punë	Përdor mjetet dhe teknikat e rekomanduara për të mbajtur nivelin e kërkuar të higjienës; Vesh rrobat mbrojtëse personale në mënyrën e			

	parashikuar; Siguron që vendi i punës është i sigurt para fillimit të punës.			
--	---	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto vegla: uniforma, udhëzues për përdorimin e pajisjeve, plane, forma të mbajtjes së librave, kompjuterë, mjete komunikimi, qasje në internet, si dhe programin e aplikimit.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje e përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathhtësitë në përgatitjen e vendit të punës.

Kandidati duhet të futet në provimin praktik në situatë të vërtetë pune në punëtori. Mbikëqyrja e kandidatit përmes demonstrimit praktik të përdorimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe aplikimit të masave higjienike dhe të sigurisë në punë.

Funksioni 2:Analizon, planifikon dhe organizon punën në fermë

Ky funksion ka të bëjë me analizën e të dhënave të prodhimit të biznesit si dhe bërjen e planeve afatshkurtra ditore dhe javore në fermë.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Analizon të dhënat e prodhimit dhe të biznesit	Kalkulon raportet bazë të produktivitetit dhe performancës; Bën parashikimin për sasinë dhe çmimin e produkteve të tregtueshme; Analizon kushtet e tregut Raporton analizat e bëra.	Kalkulimi i produkteve të thjeshta dhe treguesit financiarë Analizën e tregut; Fazat në ciklin e riprodhimit të kafshëve të fermave	Analizimi të dhënave Kalkulimi bazik dhe parashikimi për nevojat në të ardhmen e afërt	Të menduarit kritik Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje
Bën plane afatshkurta	Planifikon furnizimet; Bën planin e riprodhimit të kafshëve; Përpilon listat kontrolluese; Bën planifikimin ditor/javor/sezonal të nevojave për punë, material dhe pajisje; Rregullon orarin për aktivitetet kyçe në prodhimin e kulturave bujqësore; Rregullon orarin për aktivitetet kyçe në mbarështimin e kafshëve; Bën planin për riprodhimin e kafshëve.	Fazat në ciklin e vegjetacionit të bimëve bujqësore Mbrojtja e bimëve Përdorimi i mjeteve dhe veglave të punës Rrezikun nga helmet dhe pesticidet Përpunimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore	Përdorimi të pajisjeve Vlerësimi të gjendjes Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Krahasimi të vlerave	Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja Organizimi Negocimi

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto vegla:uniforma, udhëzues për përdorimin e pajisjeve, kompjuterë me “office softuer”, mjete komunikimi, qasje në internet, si dhe, nëse kërkohet softuer-in përkatës për profesionin.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje e përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathhtësitë bazike në kryerjen e organizimit të të dhënave, prezantimit dhe analizës.

Kandidati duhet të futet në provimin praktik në situatë të vërtetë pune në punëtori. Monitorimi i kandidatit përmes demonstrimit praktik të përgatitjes së mjedisit për kryerjen e hulumtimit dhe analizës së kulturave dhe zhvillimit të metodave të reja për të përmirësuar procesin e kultivimit dhe metodat e tij, si dhe përdorimin e veglave dhe pajisjeve të punës.

Funksioni 3: Kryen aktivitetet operative në prodhimtarinë me prejardhje bimore

Ky funksion ka të bëjë me prodhimin e fidaneve perimore, kultivimin e perimeve në ambiente të hapura dhe të mbyllura, kultivimin e pemëve frutore si dhe fidaneve të tyre, kultivimin e drithërave, kulturave hortikulturale, mbrojtjen e tyre, si dhe transportin dhe deponimin e kulturave të vjelura bujqësore. Përdorimi i veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje bimore është poashtu pjesë e këtij funksioni.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Prodhon fidanet perimore	Përzgjedh parcelën dhe merr mostrën; Përgatitë farën për mbjellje; Përgatitë vendin për prodhimin e fidaneve; Mbjell farën për prodhimin e fidaneve; Kryen shërbimet pas mbjelljes së farës si dhe ujitjen e saj; Përgatitë fidanët për ndërrim.	Të ushqyerit e bimëve Kërkesat ushqimore të bimëve Bazat e fiziologjisë së bimëve Parimet e shumimit të bimëve Speciet dhe llojet e bimëve Njohuritë bazë mbi llojet e tokave Njohuri të përgjithshme mbi përgatitjen e tokës për mbjellje;	Analizimi i të dhënave Vlerësimi i kushteve optimale për mbjelljen e kulturave bimore Përzgjedhja e saktë e parcelës për mbjellje Zbatimi i duhur i masave agroteknike Përzgjedhja dhe përdorimi i saktë i pajisjeve;	Të menduarit kritik Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja
Kultivon perimet në ambiente të hapura	Përgatitë tokën për mbjelljen e fidanëve; Përgatitë fidanin për mbjellje; Mbjell fidanë në vendin e përhershëm; Kryen shërbimet kulturore pas mbjelljes së fidanëve, në vendin e përhershëm si dhe ujitjen e tyre; Vjelë, seleksionon dhe përgatitë	Llojet dhe parimet e përdorimit të plehrave; Sëmundjet më të rëndësishme të bimëve Njohuri mbi agjentët për mbrojtjen e bimëve; Njohuri në masat agroteknike;	Kreativiteti në optimalizimin e rendimenteve Zbatimi i saktë i masave agroteknike Koordinimi i veprimeve sipas nevojës;	Organizimi Negocimi

	për treg prodhimet e perimeve.	Teknikat e ujitjes Bazat e standardeve për sigurim të cilësisë: <ul style="list-style-type: none"> • ISO • EUROPEGAP • GLOBALGAP Mekanizmin bujqësor dhe mirëmbajtjen e mekanizimit bujqësore	Krahasimi i vlerave; Zbatimi i rregullave strikte shëndetësore dhe higjienike Identifikimi dhe klasifikimi i saktë i produkteve sipas rëndësisë ekonomike; Veprimi i shpejtë në rast të mosfunksionimit, duke parandaluar humbjen e produktit; Përdorimi të sistemit të ujësjellësit Llogaritjeje bazike matematikore
Kultivon perimet në ambiente të mbyllura (sera)	Kryen përgatitjen e tokës për mbjelljen e perimeve në serra; Përgatitë fidanët për ndërrim në vendin e përhershëm; Bënë ndërrimin (mbjelljen) e bimëve perimore në serra; Kryen shërbimet agroteknike gjatë vegetacionit të bimëve perimore në serra si dhe ujitjen e tyre. Vjelë, seleksionon dhe përgatitë për treg prodhimet e perimeve.		
Kultivon pemët frutore (prodhimin e fidanëve të pemëve)	Zbaton mënyrat e shumimit vegetativ dhe gjenerativ; Kryen shërbimet agroteknike në fidanishte për drunjët dekorativ dhe pemët frutore ; Përgatitë për shitje fidanet; Përgatitë tokën për mbjelljen e fidaneve të pemëve frutore; Mbjellë fidane të pemëve frutore në mënyrë të sistemuar dhe të piketuar; Realizon krasitjen si dhe shërbimet tjera agroteknike.		
Kultivon drithërat	Kryen veprime parapërgatitore për mbjelljen e farës;		

	<p>Mbjell drithërat;</p> <p>Kryen shërbimet agroteknike gjatë rritjes së drithërave.</p> <p>Vjelë, seleksionon dhe përgatitë për treg prodhimet e drithërave.</p>			
Kultivon kulturat hortikulturale	<p>Përpilon planin hapësinor për ngritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytete dhe në vendbanime;</p> <p>Përgatitë tokën për ngritjen e kopshteve;</p> <p>Përdorë elementet arkitektonike në kopshte dhe hapësira të gjelbëruara;</p> <p>Mbjellë barin dhe fidane të bimëve dekorative;</p> <p>Kryen shërbimet agroteknike për mirëmbajtjen e sipërfaqeve dhe mureve të gjelbërta</p>			
Bën mbrojtjen e bimëve	<p>Aplikon agjentët për mbrojtje të bimëve në kohë dhe sipas gjendjes së bimës</p> <p>Bën luftimin e barojave të këqija, sëmundjeve, brejtësve, insekteve, etj duke përdorur preparate kimike sipas standardeve.</p>			
Vjelë, transporton dhe deponon kulturat bujqësore	<p>Kryen vjeljen në kohën e duhur duke përdorë pajisjet dhe veglat e duhura në mënyrën e duhur;</p> <p>Transporton kulturat e vjelura</p>			

	bujqësore; Klasifikon kulturat e vjelura bujqësore; Paketon kulturat e vjelura bujqësore; Deponon kulturat e vjelura bujqësore Aplikon standarde specifike për sigurim të cilësisë.			
Përdor veglat dhe pajisjet në prodhimtarinë me prejardhje bimore	Përcakton pajisjet sipas aktivitetit të caktuar; Përdor pajisjet dhe veglat e punës; Mirëmban pajisjet dhe veglat e punës.			

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto vegla: uniformat, mikroskopin, gotën laboratorike, pincën, kompjuterin, çaka, lopata, ashovë, sharrë, kolicë, grabuj, shati, kazme (tarnakop), teslic, tërfurk, sopat, drapër, teshat dhe dorëzat e punës, pompa për spërkatje + teshat për spërkatje, gërshërët për armaturë, gërshërët për shimshirë, veglat për krasitje dhe shartim, gërshërët për krasitjen e pemëve, sharra për prerjen e degëve, brisqet për shartim (të gjitha llojet), limë dhe rryp për mprehjen e brisqeve, kultivatori, pllugu me pjesë përbërëse (plori +veshi), disqe, freza, leas, rula, makina kositje e barit, atomizer, traktor, rimorkio.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje e përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathhtësitë bazike në përgatitjen e tokës për mbjellje, mbjelljen e kulturave bujqësore, përdorimin e plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve, shartimin e tyre, krasitjen, ujitjen, spërkatjen, vjeljen, klasifikimin, transportin dhe deponimin e kulturave bujqësore.

Funksioni 4: Kryen aktivitetet operative në prodhimtarinë me prejardhje blegtorale

Ky funksion ka të bëjë me pastrimin dhe vendqëndrimin të kafshëve, ushqimin e kafshëve të fermës sipas gjendjes dhe kategorisë së tyre, përkujdesjen dhe shumimin e tyre, trajtimin e tyre dhe produktet blegtorale sipas standardeve për sigurim të cilësisë, siguri të ushqimit dhe mirëqenie të kafshëve, grumbullimin, ambalazhimin, transportimin, si dhe deponimin e produkteve blegtorale, mirëmbajtjen dhe pastërtinë e vendit për deponimin e produkteve dhe ushqimit të kafshëve si dhe përdorimit të veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje shtazore

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Pastron vendqëndrimin e kafshëve	Pastron dhe dezinfekton vendqëndrimin e kafshëve; Mirëmban pastërtinë dhe higjienën në vendin për deponim të produkteve dhe ushqimit të kafshëve;	Llojet dhe racat e kafshëve shtëpiake Bazat e riprodhimit të kafshëve të fermës Bazat e anatomisë së kafshëve	Vlerësimi të gjendjes së kafshëve; Identifikimi të nevojave të kafshëve Zbatimi të mënyrave të sakta të mbarështimit të kafshëve shtëpiake sipas llojit të tyre	Të menduarit kritik Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja Organizimi Negocimi
Ushqen kafshët e fermës sipas gjendjes së kafshëve dhe kategorisë	Përgatit racionet ushqimore ditore sipas gjendjes dhe kategorisë së kafshëve Përzgjedh sasi të nevojshme për përgatitjen e racioneve Ushqen kafshët sipas gjendjes dhe kategorisë së tyre	Kushtet e shumimit të kafshëve të ndryshme shtëpiake Teknologjinë e prodhimtarisë blegtorale; Njohuri të nevojshme për të ushqyerit e kafshëve sipas udhëzimeve blegtorale	Përzgjedhjeje dhe përdorimi të saktë të pajisjeve; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Llogaritjeje bazike matematikore Veprimi të shpejtë në rast të	
Përkujdeset për kafshët dhe shumimin (mbarështimin) e tyre	Vëzhgon dhe vëren ndryshimet në dukjen dhe sjelljen e kafshëve; Ndërmerr masa adekuate në rast të gjendjes apo sjelljeve të papërshtatshme të kafshëve;	Sëmundjet më të zakonshme të kafshëve dhe trajtimi i tyre Përgatitja e racioneve ushqimore		

	<p>Komunikon gjendjen e vërejtur në mënyrë të qartë dhe me kohë te personeli kompetent.</p> <p>Përcakton gjendjen për mundësi çiftëzimi në tufë;</p> <p>Kujdeset për tufë (kopenë) gjatë çiftëzimit;</p> <p>Zbaton procedurat e përshtatshme të kujdesjes për tufën (kopenë) në lindje;</p> <p>Përkujdeset dhe ofron kushte për kafshët në linjë me kërkesat për mirëqenie të kafshëve</p>	<p>Të ushqyerit e kafshëve sipas kategorizimit të tyre</p> <p>Përkujdesja ndaj kafshëve</p> <p>Pastrimi i fermës dhe mjeteve përkatëse sipas standardeve (preparatet e nevojshme, mjetet dhe veglat e punës etj)</p> <p>Inspektimi vizual i kafshëve;</p> <p>Komunikimi me personin përgjegjës (veterinerin) mbi inspektimin vizual të kafshëve.</p> <p>Higjiena dhe shëndeti i kafshëve</p> <p>Standardet për sigurim të cilësisë dhe siguri të ushqimit si HACCP, halal, kosher....</p>	<p>mosfunksionimit, duke parandaluar humbjen e produktit;</p> <p>Zbatimi të procedurave në përdorimin e preparateve kimike në fermë</p> <p>Menaxhimi të duhur i produkteve blegtorale deri në deponim</p>	
<p>Trajton kafshët dhe produktet blegtorale sipas standardeve për sigurim të cilësisë, siguri të ushqimit dhe mirëqenie të kafshëve</p>	<p>Mjelë kafshët;</p> <p>Mbledh dhe klasifikon vezët;</p> <p>Mbledh pulat;</p> <p>Përzgjedhë kafshët sipas qëllimeve të veçanta;</p> <p>Kufizon dhe trajton kafshët për aktivitete të veçanta;</p>			
<p>Grumbullon, ambalazhon, transporton dhe deponon produktet blegtorale</p>	<p>Grumbullon produktet blegtorale;</p> <p>Klasifikon produktet blegtorale</p> <p>Ambalazhon dhe transporton produktet blegtorale;</p> <p>Deponon produktet blegtorale;</p>			

Përdor veglat dhe pajisjet në prodhimtarinë me prejardhje shtazore	Përcakton pajisjet sipas aktivitetit të caktuar; Përdor pajisjet dhe veglat e punës në mënyrën e duhur; Mirëmban pajisjet dhe veglat e punës.			
--	---	--	--	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto vegla: veshe-mbathje për punë, dorëza dhe syze mbrojtëse , vendqëndrim për kafshë, kafshë shtëpiake, përzierëse ushqimi, ushqyes mjete për ujë për pastrim të kafshëve, modele dhe foto/ vizatime të kafshëve, aparaturën për mjelje, kova dhe kontejner për bartjen e produkteve bujqësore, laborator biokimik për analizën e mostrave të ushqimit dhe kafshëve, fshesë dore dhe pajisjet tjera për pastrim si dhe materiale për pastrim.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje e përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathtësitë bazike në kryerjen e pastrimit të vendqëndrimit të kafshëve, ushqimin e kafshëve të fermës sipas gjendjes dhe kategorisë së tyre, përkujdesjen e tyre, si dhe përdorimit të veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje shtazore.

Kandidati duhet të futet në provimin praktik në situatë të vërtetë pune në punëtori. Monitorimi i kandidatit përmes demonstrimit praktik të pastrimit të vendqëndrimit të kafshëve, ushqimin e kafshëve të fermës sipas gjendjes dhe kategorisë së tyre, përkujdesjen e tyre, si dhe përdorimit të veglave dhe pajisjeve në prodhimtarinë me prejardhje shtazore.

Funksioni 5: Kryen shitblerjen dhe marketingun e produkteve bujqësore – blegtorale (rregulloje)

Ky funksion ka të bëjë me kalkulimin e kostove në prodhimtarinë bujqësore – blegtorale, hulumtimin për blerjen e inputeve bujqësore dhe blegtorale si dhe përgatitjen e strategjisë së marketingut dhe shitjes së atyre produkteve.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Kalkulon kostot e shpenzimeve dhe profiteve në prodhimtarinë bujqësore-blegtorale	Evidenton shpenzimet dhe hyrjet në fermën bujqësore-blegtorale; Mban shënimet për të hyrat dhe të dalat në fermë; Mban shënimet për të hyrat në fermë; Distribuon fitimet-humbjet në fermë; Eliminon shpenzimet e panevojshme në prodhimtarinë bujqësore-blegtorale.	Evidentimi i shpenzimeve Mbajtja e shënimeve Librat e blerjes dhe shitjes Distribuimi financiar ; Hulumtimi i tregut Marketingu Organizimi i blerjeve të inputeve bujqësore-blegtorale	Llogaritjeje dhe prezantimi të dhënave Hulumtimi dhe organizimi të tregut; Zbatimi të strategjisë për blerjen e inputeve dhe shitjen e produkteve bujqësore blegtorale; Prioritizimi të aktiviteteve Përzgjedhjeje dhe përdorimi të saktë të pajisjeve; Vlerësimi bazik të produkteve bujqësore -blegtorale; Koordinimi i veprimeve sipas nevojës; Krahasimi të vlerave; Veprimi të shpejtë në rast të mosfunksionimit, duke parandaluar humbjen e	Të menduarit kritik Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja Organizimi Negocimi
Hulumton tregun për blerjen e inputeve bujqësore – blegtorale dhe mjeteve të punës	Sistematizon tregun për blerjen e inputeve bujqësore; Ndan blerësit sipas karakteristikave të produkteve	Hulumtimi i tregjeve të shitjes Përpilimi i ofertave Organizimi i shitjeve Nevojat e konsumatorëve Nevojat e tregut Konkurrenca e tregut Shpërndarja e produkteve bujqësore ne tregje		
Bën strategjinë për mbulimin e tregut, shitjen e	Hulumton tregjet për shitjen e produkte bujqësore-			

prodhimeve finale, përmbushjen e kërkesës së konsumatorëve si dhe hulumtimin e konkurrencës	blegtorale. Përpilon oferta të ndryshme; Evidenton kërkesat e konsumatorëve; Organizon furnizimin e tregut Vëzhgon konkurrencën e tregut dhe planet e konkurrentëve; Distribucion prodhimtarinë		produktit;	
---	--	--	------------	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion dhe të përdorë këto vegla: kompjuterin, kalkulatorin, forma të përshkuara të marketingut, softuer (pakon office), mjetet e komunikimit si dhe pajisjet tjera përkatëse.

Kriteret e vlerësimit:

Testi me shkrim dhe pyetje e përgjigje për të demonstruar njohuritë dhe shkathhtësitë bazike në kalkulimin e kostove në prodhimtarinë bujqësore – blektorale, hulumtimin për blerjen e inputeve bujqësore dhe blektorale si dhe përgatitjen e strategjisë së marketingut dhe shitjes së atyre produkteve.

Kandidati duhet të futet në provimin praktik në situatë të vërtetë pune në punëtori. Monitorimi i kandidatit përmes demonstrimit praktik të kalkulimit të kostove në prodhimtarinë bujqësore – blektorale, hulumtimin për blerjen e inputeve bujqësore dhe blektorale si dhe përgatitjen e strategjisë së marketingut dhe shitjes së atyre produkteve.

Funksioni 6: Zbaton rregullat sigurisë dhe mbron ambientin

Ky funksion ka të bëjë me aplikimin e rregullave të higjienës personale dhe sigurisë në punë, aplikimin e rregullave për siguri të ushqimit, aplikimin e praktikave të mira në trajtimin e kafshëve dhe bimëve si dhe aplikimin e praktikave miqësore ndaj mjedisit për hedhjen e mbeturinave.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës	Njohuritë e duhura për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë që lidhen me aktivitetet kyçe
Aplikon rregullat e higjienës personale dhe sigurisë në punë.	Mban nivelin e kërkuar të higjienës personale dhe masave të sigurisë në punë.	Rreziqet potenciale të shoqëruara me vargun e aktiviteteve punuese dhe mjetet për t'i zvogëluar rreziqet;	Identifikimi të rreziqeve potenciale me saktësi;	Të menduarit kritik Sjellje ndërnjerëzore Komunikimi Llogaritjeje Zhvillimi personal dhe profesional Njohuri të gjuhëve të huaja Organizimi Negocimi
Aplikon rregullat për siguri të ushqimit.	Përdor preparatet kimike, në fermë sipas standardeve.	Treguesit e rreziqeve;	Përdorimi të pajisjeve, veglave dhe materialeve në mënyrë të sigurt;	
Aplikon praktikat e mira në trajtimin e kafshëve dhe bimëve	Trajton kafshët dhe bimët në pajtueshmëri me standardet.	Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit për të siguruar shëndetin dhe sigurinë;	Përdorimi të mjeteve të ndihmës së parë;	
Mbanë ambient të pastër dhe higjienë në vendin e punës	Përzgjedh veglat dhe materialet sipas përdorimit të tyre për mirëmbajtjen e higjienës dhe pastërtisë në fermë (bujqësore-blegtorale); Kryen një sërë detyrash për mirëmbajtjen e fermës në linjë me standardet për cilësi dhe siguri të ushqimit; Operon në mënyrën e duhur me veglat dhe pajisjet e punës që përdoren për mirëmbajtjen e fermës; Regjistron aktivitetet e kryera.	Cilat paralajmërimet, alarmimet verbale dhe vizuale janë të kërkuara; Masat paraprake të sigurisë duke përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale; Rëndësinë e pastërtisë në hapësirën e punës; Cilat materiale punuese të përdoren dhe si të përdoren	Trajtimi të mbeturinave në mënyrë të sigurt sipas karakteristikave të saj. Mbajtja e drejtë e higjienës personale. Gatishmëri në zbatimin e rregullave të higjienës dhe sigurisë në punë. Veprimi i shpejtë në rast të mosfunksionimit, duke	

<p>Aplikon praktikat miqësore ndaj mjedisit për hedhjen e mbeturinave.</p>	<p>Menaxhon mbeturinat dhe produktet e panevojshme në mënyrën që nuk është e dëmshme për mjedisin. Deponon dhe menaxhon plehun organik dhe përfiton kompostin</p>	<p>në mënyrë të sigurt; Identifikimi dhe trajtimi i pajisjeve, veglave dhe materialeve të dëmtuara. Parimet e praktikave të mira bujqësore; Parimet e sigurisë së ushqimit dhe standardet e cilësisë; Parimet e kërkesave të mbrojtjes së ambientit që kanë të bëjnë me bujqësi</p>	<p>parandaluar humbjen e produktit; Zbatimi i drejtë procedurave në përdorimin e pesticideve;</p>	
--	---	---	---	--

Kushtet e realizimit të funksionit:

Për të kryer këtë funksion, kandidati duhet të ketë në dispozicion mjetet përkatëse për to mirëmbajtjen e ambientit të punës dhe mbrojtjes së ambientit si dhe pajisjet tjera përkatëse.

Kërkesat e vlerësimit:

Test me shkrim i njohurive dhe pyetje – përgjigjet për të demonstruar që nxënësi i ka kuptuar kërkesat e punës, diskutim profesional.

Vëzhgim i kandidatit nëpërmjet demonstrimit praktik se si kryhen aktivitetet, grumbullohen nëpërmjet vëzhgimit të kandidatit duke i bërë këto aktivitete (të përshkruara në funksion) në një situatë reale të punës. Kontrollimi i ambientit të punës /listë kontrolli.